



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM

“PËR PËRCAKTIMIN E FREKUENCAVE PËR SHËRBIMIN E TRANSMETIMIT AUDIO DHE ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 1 (NJË) LICENCE TRANSMETIMI AUDIO ANALOGE”

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie e licencës së transmetimit audio analoge”, miratuar me vendim nr. 7, datë 21.02.2023 të AMA-s, si dhe vendimit nr. 7, datë 21.01.2025 të AMA-s, “Për përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e garës për dhënie e 1 (një) licence të transmetimit audio analoge”, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidaturave për dhënie e 1 (një) licence transmetimi audio analoge.

Për zonat e mëposhtme:

Nr	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pikat e transmetimit	Frekuenca (MHz)
1.	Qarku Kukës	Audio Analoge	Tregtan	95

Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë transmetimi audio analoge, janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë, ***brenda datës 25.05.2025, ora 10:00.***

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidaturave, që përfshin:

- Rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënie e licencës së transmetimit audio analoge”, e ndryshuar;
- Kërkesat që duhet të plotësojë aplikimi;
- Kriteret teknike për ofrimin e shërbimit audio përfshirë frekuencën/frekuencat dhe pikën/pikat e transmetimit për zonën e shërbimit;
- Pagesat për licencën, tarifatat përkatëse dhe mënyrën e pagesës së tyre.

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA, pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen ***në datë 25.05.2025, ora 10:00, në mjediset e AMA-s***, ku subjektet aplikues apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.